

Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Sportit

Misioni Përgjegjësi i Sektorit drejton dhe menaxhon punën e sektorit. Ai mban kontakte të drejtpërdrejta me Drejtorin e Drejtorisë dhe Përgjegjësit e sektorëve të tjerë për të siguruar cilësi në punën që kryen. Detyrat

1. Të ndjekë dhe ndikojë në mbarëvajtjen e punës në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës, për të gjitha kategoritë dhe grup moshat që përfshin Bashkia Prrenjas;

2. Në bashkëpunim me Zyren Arsimore merr masa për garantimin e disiplinës në punë dhe respektimin e kërkesave të rregullores së shkollës;

3. Përgatit analiza, raporte, relacione dhe informime për sektorin. Një herë në muaj informon drejtorin dhe kur është e nevojshme Kryetarin e Bashkisë për mbarëvajtjen e sektorit dhe me kërkesë të tij e për arsye problemore informon edhe Këshillin Bashkiak;

4. Harton tematikat përkatëse për ta paraqitur në analizat periodike të Këshillit të Bashkisë;

5. Në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përgatit materialet për bursat e nxënësve e studentëve dhe i paraqet në Këshillin Bashkiak për shqyrtim e miratim;

6. Bashkëpunon me Sektorin e Shëndetësisë dhe Shërbimet Publike për garantimin e higjenës në ambientet shkollore dhe arsimin parashkollor. Harton për këtë çështje kontrolle tematike të përbashkëta, si dhe kontrolle operative të vazhdueshme;

7. Bashkëpunon me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë në aparat për të siguruar aktivitete të arsimit, binjakëzime me institucione homologe, pritje të delegacioneve e grupeve të ndryshme etj;

8. Punon për administrimin dhe gjallërimin e jetës kulturore dhe artistike, në përputhje me politikat e Bashkisë, me fokus të veçantë zhvillimin e aktiviteteve rinore;

9. Përgatit materialin e duhur për një projekt kulturor (shkresa përcjellëse, kontrata, çelje fondi) dhe e ndjek atë deri në financimin e projektit;

10. Mbikqyr organizimin dhe realizimin kulturor të gjithë ceremonialeve zyrtare;

11. Koordinon punën me sektorë të tjerë, për realizimin e projekteve të përbashkëta të fushës kulturore dhe artistike;

12. Ndjek organizimin e veprimtarive kulturore sipas parashikimit të kalendarit vjetor.
13. Evidenton pasuritë kulturore të qytetit, si ato arkeologjike, etnografike, figurat historike të qytetit etj., dhe organizon veprimtari për promovim vlerash;
14. Trajton akordimin e titujve dhe stimujve vendor te nderit për personalitete me kontribut të shquar në fushen e arsimit dhe shkencës dhe përgatit projekt-vendimet përkatëse për Këshillin e Bashkisë.
15. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit Financiar harton e miraton në Këshillin e Bashkisë buxhetin e vitit për kulturën dhe ndjek zbatimin e tij në proces;
16. Kryen edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprorët e tij.